



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1561/ 19 prot.

Datë 09.10.2025

V E N D I M

Nr. 1422/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-45063-04-15-2025, me objekt: “Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për Njësinë Speciale Renea, Njësinë Speciale Anti-Eksploziv dhe Njësinë Speciale Negocim”, me fond limit 69,307,413 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh ose 696,486.91 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 19.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK me NIPT: K11507003S dhe me adresë: Rruga “Bardhok Biba”, Pallati “Trema”, Hyrja C, Kodi Postar 1016, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Silver” SHPK me NIPT: K88010301S dhe me adresë: Rruga “Bajram Curri”, Nr. Pasurie 5/247+1N4, Zona Kadastrale 8260, Pallati “Palma e Art”, Kati 1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.04.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference Nr. REF-45063-04-15-2025, me objekt: “Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për Njësinë Speciale Renea, Njësinë Speciale Anti-Eksploziv dhe Njësinë Speciale Negocim”, me fond limit 69,307,413 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh ose 696,486.91 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 19.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

II.2. Në datë 19.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 03.06.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Silver” SHPK	49,864,800 leke	kualifikuar
2. “Dajti Park 2007” SHPK	51,418,260 leke	kualifikuar
3. “4S” SHPK	64,395,000 lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 10.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “Silver” SHPK.

II.5. Në datën 17.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5428, datë 17.06.2025, dhe me nr. 1561/2025 prot, datë 17.06.2025 e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë vijon:

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik, Neni 109 “E drejta e ankimit”, Neni 110 “Afatet për ankim”, Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021) kërkojmë shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria Silver sh.p.k pasi nuk plotëson Kriteret e Përgjithëshme dhe të Vecanta të Dokumentave Standrte të Tenderit.

- Pranimi i ofertes se subjektit Silver sh.p.k eshte bere pa verifikimin e plote te kapaciteteve te tij, duke shkelur parimet e konkurrences dhe transparences te percaktuara nga ligji.

- Institucionet pergjegjese kane deshtuar te ofrojne informacion te plote, duke penguar te drejten tone per te mbrojtur interesat ligjore.

I. Sipas Ekstraktit Historik te kesaj shoqerie vendet e ushtrimit te aktiviteti ku kryen aktivitetin tregtar dhe ku kryen sherbimin e gatimit (Kateringut), jane:

Seli/Zyra Qendrore: Tirane, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-re.

- Ambiente gatimi:

- 1. Tirane, Yzberisht, ZK 3866, Nr. Pasurie 306/179+2-N1.*
- 2. Vlore Orikum, Repart Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlore Tirane.*
- 3. Vlore Orikum, Reparti Special per Kufirin dhe Migracionin Delta, Rradhime, Vlore.*
- 4. Shkoder, Reparti i Nderhyrjes se Shpejte, Rruga Levizja e Postribes, Shkoder.*

- Mjete Frigoriferike:

- 1. Mjet frigoriferik me targe AA417ET dhe numer shasie ËV1ZZZ2KZ6X100708 Tirane.*
- 2. Mjet Frigoriferik me Targe AB 372 AG dhe numershasie Ë0L6ËZU1AH9601535 Tirane.*

- Kamiona:

- 1. Kamion Iveco Magirus me Targe AA395LY dhe Nr. Shasie ËJMA1VP0004254091 Tirane.*
- 2. Autobot Man me Targe AA846NX dhe Nr. Shasie ËMAL770509Y034864 Tirane.*
- 3. Tirane Kamion Mercedes Benz me Targe AA271XD dhe Nr. Shasie ËDB6114181P207133.*

II. Referuar QKB-se <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-l-ejet-e-leshuara-nga-qkb/> ka aktive keto Licenca: Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve LN-4682-09-2022 Aktive 19.09.2022 Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis LN-4248-06-2022 Aktive 10.06.2022 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve LN-5437-03-2023 Aktive 15.03.2023 Shpues profesionist per uje LN-6593-11-2023 Aktive 20.11.2023. Sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore LN-3651-02-2022 Aktive 09.02.2022 Sherbime ekspertize higjeno-shendetesore LN-2926-09-2021 Aktive 20.09.2021 Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe/ose fidaneve LN-5589-08-2012 Aktive 31.08.2012 Sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore LN-4535-01-2012 Aktive 30.01.2012 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve LN-5054-05-2012 Aktive 02.05.2012 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve LN-9557-05-2025 Aktive 02.05.2025 Veprimtari ne fushen e Shendetit Publik qe nuk lidencohen sipas nje kategorie tjeter LN-3297-12-2021 Aktive 01.12.2021 Sherbime ekspertize LN-4918-04-2012 Aktive 06.04.2012 Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve LN-6349-09-2023 Aktive 19.09.2023.

III. Referuar https://openprocurement.al/sq/agency/list/corporate_id/K88010301 ky operator ka aktive keto kontrata:

- 1. Kontrate Nr 422 DT 31.01.2025, Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi ne Spitalin Rajonal Vlore.*
- 2. Kontrate me Reparti Ushtarak Nr.4300 Tirane, Furnizime dhe sherbime me ushqim per mecat kont vazhd 4738/4 dt 31.10.2024.*
- 3. Kontrate Loti 4 - Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Repartin Ushtarak Nr.2030 distrikti Detar Jugor Pashaliman, Vloreë.*
- 4. Kontrate Sherbim gatimi dhe shperndarje Ushqimi per Spitalin Rajonal Shkoder.*

5. Kontrate LOTI 4- Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Repartin Ushtarak Nr.2001 Pashaliman Vlore.
6. Kontrate Nr 1 DT 01.01.2025 Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi, per Repartin Special per Kufirin dhe Migracionin Delta.
7. Kontrate Nr 46 dt 27.02.25, Loti 3 Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Repartin e Nderhyrjes se Shpejte Shkoder.
8. Kontrate Nr 2019 prot dt 31.12.2024 Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi, per Spitalin Rajonal Elbasan si BOE Gerti - 1987 sh.p.k & Silver sh.p.k.

IV. Sipas DST-ve perkatese ne te gjitha keto lote ku operatori ekonomik eshte shpallur fitues Dhe ka nje kontrate aktive jane:

1. Ne Kontraten e nenshkruar nga ky operator ekonomik me objekt: Sherbimi gatimi dhe shperndarje ushqimi ne spitalin Rajonal Vlore, Kriteret e veçanta te kulifikimit pika 2.3.3 Operatoret ekonomike, per kryerjen e sherbimit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, objekt prokurimi duhet te kene jo me pak se 14 (katermbdhjete) persona te punesuar, sipas profesioneve ne tabelen e meposhtme:

- Drejtues teknik/Pergjegjes Sherbimi 1 (nje).
 - Kuzhinier 2 (dy).
 - Ndhimes Kuzhinier 4 (kater).
 - Punonjes shperndares ushqimesh ne ambientet e AK 6 (gjashte).
 - Shofer 1 (nje).
- Total 14 (katermbdhjete).*

2. Ne Kontraten e nenshkruar nga ky operator ekonomik me objekt: LOTI 1: Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Rajonal Shkoderë. Kriteret e vecanta te kulifikimit pika 2.3.3 Operatoret ekonomike, per kryerjen e sherbimit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, objekt prokurimi duhet te kene jo me pak se 6 (te) persona te punesuar, sipas profesioneve ne tabelen e meposhtme:

- Drejtues teknik/Pergjegjes Sherbimi Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor 1 (nje).
 - Kuzhinier 2 (dy).
 - Ndhimes Kuzhinier/ sherbyes gatimi 2 (dy).
 - Shofer 1 (nje).
- Total 6 (gjashte).*

3. Ne Kontraten e nenshkruar nga ky operator ekonomik me objekt: Sherbim gatimi dhe shperndarje ushqimi per Spitalin Rajonal Elbasan. Kriteret e vecanta te kulifikimit pika 2.3.3 Operatoret ekonomike, per kryerjen e sherbimit te gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, objekt prokurimi duhet te kene jo me pak se 14 (katermbdhjete) persona te punesuar, sipas profesioneve ne tabelen e meposhtme:

- Drejtues teknik Mercollog/Kimist 1 (nje).
- Kuzhinier 2 (dy).
- Ndhimes Kuzhinier 4 (kater).
- Punonjes shperndares ushqimesh ne ambientet e AK 6 (gjashte).
- Shofer 1 (nje).

Total 14 (katërmëdhjetë).

4. Në kontratën e nënshkruar nga ky operator ekonomik me objekt Loti 4 - Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.2030 distriktidetar Jugor Pashaliman, Vlorë. Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë punonjësit e mëposhtëm:

- Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist) 1 (një).*
- Kryekuzhinier 1 (një).*
- Kuzhinier 1 (një).*
- Ndihmes Kuzhinier 2 (dy).*
- Punonjes shpërdares ushqimesh 2 (dy).*
- Sanitare 2 (dy).*
- Shofer 1 (një).*

Total 10 (dhjetë).

5. Në kontratën e nënshkruar nga ky operator ekonomik me objekt Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Repartin Special për Kufirin dhe Migracionin Delta. Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 5. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

- Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/teknolog).*
- Kuzhinier 2.*
- Ndihmes Kuzhinier 2.*
- Punonjes shpërdares ushqimesh/Shofer 2.*

Total 7 (shtatë).

6. Në kontratën e nënshkruar nga ky operator ekonomik me objekt Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Repartin e Nderhyrjes së Shpejte Shkoder. Kriteret e vecanta të kualifikimit pika 5. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

- Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/teknolog) 1.*
- Kuzhinier 2.*
- Ndihmes Kuzhinier/shërbyes gatimi 4.*
- Punonjes mirmbajtje /Shofer 1.*

Total 8 (tete).

Në të gjitha keto DST për të cilat ky operator ekonomik ka nënshkruar kontratat, kanë kushtin e Automjetit Frigoriferik i cili është ngushtesisht i lidhur me licencat që ky operator disponon, shërbimin e kateringut dhe me garantimin e sigurisë ushqimore dhe planit HACCP.

Me një mbledhje të thjeshtë të numrit total të stafit të kërkuar për kontratat që ka në zbatim

Rezulton:

- Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/Teknolog/ Pergjegjes Sherbimi) 6 Punonjes
- Kryekuzhinier 1 Punonjes
- Kuzhinier 11 Punonjes Punonjes
- Ndhimes Kuzhinier 16 Punonjes
- Punonjes shperndares ushqimesh 20 Punonjes
- Sanitare 2 Punonjes
- Shofer 7 Punonjes

Totali i punonjseve te kerkuar per te cilin ky operator ekonomik ofron sherbimin eshte 59 punonjes. Pa llogaritur speciliste te tjera si p.sh Administratori, Finacieri, Ekonomist, Jurist, Inxhinier Mjedisi apo specilist te tjere te fushave ku kjo shoqeri ushtron aktivitetin e saj.

V. Formulari i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike per gatim dhe shperndarje te ushqimit ne njesine speciale Renea Tiranë.

I. Kerkesa te pergjithshme

- Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive perkatese te miratuara.
- Gatimi i ushqimit per punonjesit e policise te Njesise Speciale Renea, te Njesise Speciale Negocim dhe te Njesise Speciale Anti-eksploziv te behet ne ambientin e Njesise Speciale Renea Tirane.
- Shperndarja e ushqimit per punonjesit e policise te Njesise Speciale Renea, te Njesise Speciale Negocimë dhe te Njesise Speciale Anti-eksplozivë te behet ne ambientin e Njesise Speciale Reneaë Tirane.
- Ne rastet kur efektivat e Njesise Speciale Renea, te Njesise Speciale Negocim dhe te Njesise Speciale Anti-eksploziv jane me sherbim jashte ambienteve te Njesise, shperndarja e ushqimit do te ndjeke vendndodhjen e tyre.

Foto nga ambjentet e kuzhines se njesise speciale renea.

Te gjitha riparimet e nevojshme qe do te behen ne ambientin e shperndarjes se ushqimit, per venien ne pune dhe funksionimin sa me normal te tyre gjate gjithë kohes se zbatimit te kontrates, do te behen nga sipermarresi me shpenzimet e veta dhe me miratimin e titullarit te autoritetit kontraktor.

- Ambientet e servirjes se ushqimit (mensa, ambientet ndihmese) do te mirembahen nga sipermarresi per funksionimin sa me normal te tyre, deri ne perfundim te kontrates.
- Sipermarresi eshte i detyruar te siguroje te gjitha orendite e pajisjet bashkekohore qe nevojiten, per perpunim, gatim, shperndarje, servirje, dhe konsumin e ushqimit, si dhe pajisjet per ruajtje te zakonshme dhe ne kushte frigoriferike.
- Te disponoje mjete transporti te pershtatshme per transport te produkteve ushqimore, te cilat te plotesojne te gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas standardeve ne fuqi. Automjetet te jene te pajisura me certificate higjeno-sanitare te leshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit te jene ne pronesi ose me qera te vertetuara me dokumente.

- Operatori ekonomik te disponoje mjete transporti frigoriferike, per transport te produkteve ushqimore ne vendin ku do te jete dislokuar efektiv i Njesise ne rastet e daljes se punonjesve ne stervitje verore/dimerore apo ne sherbime operacionale jashte rrethit. Mjetet e pajisjet te jene te pershtatshme edhe per kushte te veshtira terreni.
 - Per ambientin e marre me qira, me perjashtim te ambienteve qe perdoren per servirjen e ushqimit, sipermarresi te paguaje qirane e ketij ambienti, sipas VKM-se nr. 672, date 02.09.2020 i per disa ndryshime ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 54, date 05.02.2014 i per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore, te ndryshuar.
 - Furnizimi me uje dhe energji elektrike do te kryhet nga vete operatori ekonomik sipas kontratave qe do te lidhe me entet perkatese furnizuese. Per te garantuar vazhdimesine e sherbimit eshte e nevojshme qe ne rast nderprerjeje te burimeve te furnizimit te vere ne dispozicion burime alternative furnizimi.
 - Sipermarresi qe do te kryej kete sherbim, duhet te lidhe kontrate per energjine dhe ujin e pijshem, me AK , duke zbatuar te gjitha rregullat dhe udhezimet perkatese.
 - Te beje shperndarjen e ushqimit te gatuar sipas orarit te percaktuar.
 - Sipermarresi duhet te siguroje personel te mjaftueshem te kualifikuar dhe me eksperience per te garantuar cilesine e ushqimit dhe sherbimin ndaj punonjesve.
 - Sipermarresi eshte pergjegjes per te gjitha demtimet qe mund tii shkaktohen shendetit te punonjesve nga ushqimi i furnizuar.
 - Autoriteti Kontraktor ka te drejte te ushtroje kontrole per zbatimin e kushteve te kontrates gjate te gjitha fazave te procesit (furnizimit te lendes se pare, perpunimit, gatimit dhe shperndarjes).
 - Sipermarresi eshte pergjegjes per sigurimin e kushteve te higjienes ne te gjitha ambientet e shperndarjes se ushqimit.
- Ne zbatim te Ligjit nr.162, date 23.12.2020 i per prokurimin publikë i ndryshuar, neni 34, pika 9, paragrafi i pare dhe VKM-se nr.285, date 19.05.2021 i per miratimin e rregullave te prokurimit publikë, neni 12, pika 10, Autoriteti/Enti kontraktor do te parashikojë klauzola per rishikimin e vleres, ne perputhje me inflacionin e publikuar.

VI.

Shtojca 9 e DST-se ka keto kriterë:

[Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Formulari i Kriterëve te Perzgjedhjes/Kualifikimit

1. Kriteret e Pergjithshme te Perzgjedhjes/ Kualifikimit

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të percaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
 - dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
 - e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
 - j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
 - k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.
- Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 10.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/entikontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

1.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

1.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se stabilimenti plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe tekniko-teknologjike për veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë të ushqimeve për njerëz.

1.1.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 9 (nëntë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Drejtues Teknik/Përgjegjës shërbimi <u>Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)</u>	1 (një)
2	Kryekuzhinier	1 (një)
3	Kuzhinier	1 (një)
4	Ndihmës Kuzhinier	1 (një)
5	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2 (dy)
6	Sanitar/e	2 (dy)
7	Shofer	1 (një)
	Total	9 nëntë

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Drejtuesin Teknik/ Përgjegjës shërbimi, Kryekuzhinierin, Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh dhe Sanitar/e.

a) **Për drejtuesin teknik/ Përgjegjës shërbimi (Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)):**

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
- Libreze pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

b) **Për kryekuzhinierin dhe Kuzhinierin:**

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,

- Kontratë pune si kryekuzhinier/ kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe sanitaret të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi dhe sanitar/e (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i permbyshur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët.

2.3.7 Operatorë ekonomikë duhet të deklarojnë se produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve janë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, konform manualit të vetekontrollit HACCP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

VII. Nga marrja ne shqyrtim te informacionit te gjendur prane <https://bid.app.gov.al>, <https://openprocurement.al/> dhe QKB-se, nga ku rezulton se ku operator ekonomik ushtron aktivitetin e tij ne te pakten 5 adresa:

1. Seli/Zyra Qendrore: Tirane, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-re.
2. Tirane, Yzberisht, ZK 3866, Nr. Pasurie 306/179+2-N1.
3. Vlore Orikum, Reparti Ushtarak 2004, Pashaliman, Vlore.
4. Vlore Orikum, Reparti Special per Kufirin dhe Migracionin Delta, Rradhime, Vlore.
5. Shkoder, Reparti i Nderhyrjes se Shpejte, Rruga Levizja e Postribes, Shkoder.

Le të ndalemi tek pjesa me rendesishme e Ligjit per Prokurimin Publik ne Nenet 2 dhe 3 të tij

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën.

Sipas detyrimeve ligjore per keto ambinte ne permbushje te kerkesave tek Shtojca 9 e DST-se pika “dh” e cila kerkon qe:

dh) nuk ka pagesa te pashlyera te taksave dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore, ose ndodhet ne nje prej kushteve te parashikuara ne nenin 76/2 te LPP-se;

- Sipas kesaj pike kerkojme qe te verifikohet nese ky operator ka dorzuar vertetimet perkatese te leshuara nga bashkite ne te cilat ky subjekt ushtron aktivitetin e tij ekonomik, konkretisht duhet te kete te pakten vertetime te leshuara nga Bashkite Shkoder, Vlore dhe Tirane sipas percaktimeve ligjore te ligjit per taksat dhe tarifat vendore.

VIII. Pika “e” e cila kerkon qe:

e) ka paguar energjine elektrike dhe ploteson kerkesat qe burojne nga legjislacioni ne fuqi. Ky informacion kerkohet per Operatoret Ekonomike, te cilet operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise.

- Sipas kesaj pike kerkojme qe te verifikohet nese ky operator ka dorzuar vertetimet perkatese te leshuara nga FSHU ne adresat ku ky subjekt tregtar ushtron aktivitetin e tij ekonomik.

- Kontretisht duhet te kete te pakten 6 (Gjashte) numra kontratash ne listen e vertetimit te leshuar. Kontratat e energjise elektrike se bashku me adresat ne te cilat eshte titullar ose perdorues subjekti tregtar Silver SHPK, te cilat jan aktive ditën e zhvillimit te tenderit.

- A rezulton te jetë subjekti tregtar Silver SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat e Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar Historik bashkalidhur ?

- nëse është përdorues në adresat e mësipërme (në ekstraktin e rregjistrimit tregtar historik), a ka patur detyrimin që subjekti tregtar Silver SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU ? Te figurojne ne emrin e kesaj shoqerie.

- Kujtojme Vendimin nr. 598/2024 të KKP-se ne te cilin eshte skulifikuar operatori ekonomik Altec SHPK me NIPT: K57923807Ë.

IX. Pika “h” e cila kerkon qe

h) kryen aktivitetin ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

- Kerkojme qe te verifikohet nese ky operator ka dorzuar Vertetimet perkatese te leshuara nga

Tatimet konkretisht (për Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a) ne te cilin duhet qe ne zbatim te kontratave te permendura me lart e cila me nje mbledhje te tjeshite te numrit total te stafit te kerkuar per kontratat qe ka ne zbatim eshte:

1. Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/Teknolog/ Pergjegjes Sherbimi) 6 Punonjes.

2. Kryekuzhinier 1 Punonjes.

3. Kuzhinier 11 Punonjes Punonjes.

4. Ndihmes Kuzhinier 16 Punonjes.

5. Punonjes shperndares ushqimesh 20 Punonjes.

6. Sanitare 2 Punonjes.

7. Shofer 7 Punonjes.

Totali i punonjseve te kerkuar per te cilin ky subjekt tregtar ofron sherbimin eshte 59 Punonjes. Pa llogaritur speciliste te tjera si p.sh Administratori, Finacieri, Ekonomist, Jurist, Inxhinier Mjedisi apo specilist te tjere te fushave ku kjo shoqeri ushtron aktivitetin e saj.

- Te verifikohet sa eshte numri i punonjseve qe ka te deklaruar ne fushen e gatimit (kateringut) sipas kodeve perkatese qe e detyron ligji ne zbatim te VKM Nr. 514 datë 20.9.2017 për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar.

- A ka ky subjekt numrin e kerkuar te stafit teknik duke qene se ushtron aktivitetin ne vende te ndryshme dhe ne zbatim te kontratave te nenshkruara duhet te kete numrin e kerkuar per sicilen kontrate pra të pakten 59 punonjes ?
- Te verifikohet sa eshte numri i drejtueseve teknik qe ky subjekt ka te punesuar duke qene se ka aktive 5 Licenca per prodhim perpunim dhe shperndarje e ushqimeve per njerez.
- Referuar Ekstraktit Historik te Shoqerise Silver sh.p.k rezulton se ka vetem dy Automjete Frigoriferike te regjistruara per ushtrimin e aktivitetit te kateringut dhe nderkohe ka te pakten 4 ambjente gatimi. Ne kontratat qe ka nenshkruar te cilat edhe gjografikisht jane shume larg njera tjetres (Orikum, Vlore, Tirane dhe Shkoder) si eshte mundur qe ky subjekt te ofroj sherbimin e tij ne furnizim dhe shperndarje te tre vakteve ushqimore ne 8 vende te ndryshme me dy automjete te regjistruara vetem ne Tirane ?
- A jane keto mungese thelbsore per ushtrimin e aktiviteti ne zbatim te kushteve te sigurise Ushqimore ?

Ne pikën 2.3.5 të DST kërkohet që Operatoret ekonomike duhet te paraqesin nje deklarate se ushqimi do te etiketohet dhe do te identifikohet nepermjet dokumenteve dhe cdo lloj informacioni tjetër, per te siguruar gjurmueshmerine e tij sipas percaktimeve ligjore ne fuqi dhe në piken 2.3.6 kerkohet qe Operatore ekonomike duhet te deklarojne se produktet e perdorura per pergatitjen e ushqimeve jane ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, konform manualit te vetekontrollit HACCP.

- Si eshte siguruar Autoriteti Kontraktor nese ky subjekt nuk ka mangesi evidente te cilat mund te verifikon lehtesisht pasi ka te administruara edhe dokumenta te meparshme nga ky subjekt ?
- Cili eshte stafi i paraqitur nga ky subjekt ne procedurat e meparshme ne te cilat eshte shpallua fitues ?
- A ka te deklaruar pjestar të stafit per kete procedure te cilet mund te jene deklaruar ne kontrata te tjera apo ne ambientet Vlore, Orikum dhe Shkoder ku ushtron aktivitetine tij dhe me qellim fitimin e kesaj procedure eshte deklaruar edhe Tirane, duke qene e theksuar ne Specifikimet teknike qe fituesi do te ushtroj aktivitetin e tij brenda ambineteve te Repartit Renea.
- A sjell kjo shkelje ne te te gjitha pikave te Nenit 2 dhe 3 të LPP-se.
- Si mund te sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik duke mos verifikuar fakte qe jane lehtesisht te verifikueshme vetem me nje veshtrim te thjeshte.
- A ka deshtuar autoriteti kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- A ka shmangur fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën.
- Kujtojmë skulifikimin e OBP-se dhe lenien ne fuqi te KPP-se mbi skulifikimin e ketij operatori ekonomik sipas vendimit Vendimit nr. 1504/2024.
- Kerkojme te verifikohet dokumentacini e administruar i cili eshte dorzuar ne kete procedure sipas Formularit te Vetdeklarimit ne te dyja fazat.

Si përfundim kërkojmë:

1. *Pezullimin e Procedurës së Prokurimit nga O.B.P sh.a deri në marrjen e Vendimit nga KPP.*
2. *Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga subjekti Silver sh.p.k.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1561/1, datë 18.06.2025 lidhur me pretendimet dhe kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “*Silver*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*Silver*” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1561/2 prot., datë 20.06.2025.

II.8. Në datë 23.06.2025, operatori ekonomik “*Silver*” SHPK ka paraqitur argumente nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1561/3 prot., datë 23.06.2025.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*Silver*” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1561/4 prot., datë 23.06.2025.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*Silver*” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1561/5 prot., datë 23.06.2025.

II.11. Në datë 26.06.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 53/2025, datë 25.06.2025 “*Vendim*”, protokolluar me tonën me nr. 1561/6 prot datë 26.06.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.12. Me shkresën nr. 1249/10 prot, datë 26.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/7 prot, datë 27.06.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 53/2025, datë 25.06.2025 ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.13. Me shkresën nr. 147 prot, datë 30.06.2025, me objekt “*Informacion mbi ankesën A/2025/5428*”, protokolluar me tonën me nr. 1561/8 prot, datë 01.07.2025, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK informacion shtesë lidhur me vendimin nr. 53/2025, datë 25.06.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK.

II.14. Me shkresën nr. 1561/9 prot, datë 03.07.2025 “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A të dorëzojë pranë institucionit tonë dokumentacionin fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “*Silver*” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni.

II.15. Me shkresën nr. 1249/12 prot, datë 09.07.2025, me objekt “*Kthim Përgjigje*” protokolluar me tonën me nr. 1561/10 prot, datë 10.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni fizik i dorëzuar nga operatori ekonomik “*Silver*” SHPK pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit të Shtojcës 8 “*Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sikurse parashikohet në pikën 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

II.16. Me shkresën nr. 1561/11 prot., datë 07.08.2025 me objekt “*Kërkesë për informacion*” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin si më poshtë:

“*Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:*

1. *Operatori ekonomik “SILVER” SHPK me numër NIPT-i: K88010301S, a ka lidhur me entin publik “OSHEE GROUP” SH.A. kontrata për furnizimin me energji elektrike, për adresat e mëposhtëme (Sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar):*

- a) *Tirane Tirane Tirane, Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Bajram Curri, Nr. Pasurie 5/247+1N4, Zona Kadastrale 8260, Pallati Palma e Arte, Kati 1-re, Tirane 1001. (Sipas Ekstraktit dt 26.04.2025- Nga verifikimet ONLINE kjo adrese eshte shtuar ne date 04/10/2024 Fq. 35-36)*
 - b) *Vlore Orikum ORIKUM VLORE, REPARTI USHTARAK 2004, PASHALIMAN, VLORE. (Sipas Ekstraktit dt 26.04.2025 - Nga verifikimet ONLINE kjo adrese eshte shtuar ne date 06/07/2023 Fq. 30)*
 - c) *Tirane, Yzberisht, ZK 3866, Nr. Pasurie 306/179+2-N1. (Sipas Ekstraktit dt 26.04.2025 - Nga verifikimet ONLINE kjo adrese eshte shtuar ne date 04/04/2025 Fq. 37)*
 - d) *Vlore Orikum VLORE, Reparti Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Rradhimë, Vlorë. (Sipas Ekstraktit dt 26.04.2025 - Nga verifikimet ONLINE kjo adrese eshte shtuar ne date 14/02/2023 Fq. 29)*
 - e) *Shkoder SHKODER Shkoder, Reparti i Nderhyrjes se Shpejte, Rruga Levizja e Postribes. (Sipas Ekstraktit dt 26.04.2025 – Nga verifikimet ONLINE kjo adrese eshte shtuar ne date 16.08.2022 Fq. 28)*
2. *A ka patur operatori ekonomik “SILVER” SHPK me numër NIPT-i: K88010301S, kontrata të vlefshme dhe aktive me entin publik “OSHEE GROUP” SH.A. dhe a ka përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet financiare dhe procedurale që burojnë nga legjislacioni në fuqi për furnizimin me nergji elektrike në datën 19.05.2025.*
 3. *A mund të konfirmoni, në mënyrë të plotë me përgjigje PO ose JO, nëse operatori ekonomik “SILVER” SHPK me numër NIPT-i: K88010301S, ka përmbushur detyrimin ligjor për të pasur kontratë të vlefshme furnizimi me emnërgji elektrike për secilën nga vendet e ushtrimit të aktivitetit të sipërpërmendura në Pikën 1?”.*

II.17. Me shkresën nr. 2511 prot, datë 11.08.2025, me objekt “ Kërkesë për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara nga OBP”, protokolluar me tonën me nr. 1561/12 prot, datë 12.08.2025, është depozituar nga ana autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara kërkesë për përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.18. Me shkresën nr. 4370/1 prot, datë 14.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/13 prot, datë 18.08.2024, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1561/11 Prot, datë 07.08.2025, protokolluar me tonën Nr. 4370 Prot, datë 11.08.2025, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion mbi kontratat e

energjisë elektrike të cilat rezultojnë në emër apo në përdorim të operatorit ekonomik "S I L V E R" Shpk me Nipt K88010301S, ju informojmë si më poshtë:

1. Të dhëna për kontratat e furnizimit me energji elektrike të operatorit ekonomik "SILVER" Shpk, me NIPT: K88010301S:

- *Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit, rezulton se subjekti në fjalë është përdorues i kontratës së furnizimit me energji elektrike me kod **TR1B030021141303**, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: **Bajram Curri, nr. 247, 1**. Kjo kontratë është me përdorues për periudhën 14 Tetor 2024 deri me 14 Tetor 2029.*

○ *Po ashtu, operatori ekonomik "SILVER" Shpk është titullar i kontratës me kod **AL0019382**, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: **Bunavi, Vlorë**. Kjo kontratë ka qënë në përdorim nga operatori ekonomik Elton Sina, për periudhën **15 Korrik 2024 deri më 15 Korrik 2025**.*

2. PAGESA E FATURËS SË MUAJIT MARS 2025:

- *Për kontratën me kod **TR1B030021141303**, për të cilën siç u informuat më sipër është përdorues "SILVER" Shpk, pagesa e faturës së muajit Mars 2025 ishte kryer në datë 10.04.2025, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës.*

3. Të dhëna të tjera për kontratat aktive:

Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit të FSHU SH.A. rezulton se subjekti nuk ka kontratë furnizimi (si titullar apo si përdorues) për çdo adresë të deklaruar sipas ekstraktit tregtar ashtu si kërkohet në shkresën tuaj.

Sikurse sqaruar më sipër, kontratë aktive në emër të tij është ajo për adresën "Bajram Curri, nr. 247, 1". Pas datës 15.07.2025 ka përfunduar afati i përdorimit për kontratën me kod AL0019382 (operatori ekonomik Elton Sina, adresa "Bunavi, Vlorë"), e cila rezulton aktive për operatorin ekonomik "SILVER" sh.p.k.

Në sistemin tonë të faturimit, verifikimi se sa kontrata furnizimi ka një subjekt dhe statusi aktual i debisë kryhet nëpërmjet numrit të kontratës ose emrit të klientit, pasi adresat e regjistruara në sistem shpesh përkrijnë me vendndodhjen e kabinave të furnizimit ose pikave të lidhjes dhe jo domosdoshmërisht me adresat reale të objekteve.

Theksojmë se detyrimi i shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A. bazuar në ligjin Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe në Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike, është përmbushur, duke lidhur kontratat e furnizimit me energji elektrike me subjektin, si dhe duke menaxhuar në sistemin e saj të dhënat e kontratës, bazuar në kërkesat specifike të klientit.

Dokumenti zyrtar që vërteton kontratat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë ndaj FSHU Sh.a. është “Vërtetimi i Debisë”. Bashkëlidhur gjeni Vërtetimin e Debisë me nr. OSHEE-2025-2593336-UY, datë 14.04.2025, i cili përfshin informacionin për periudhën për të cilën ju referoheni.”.

II.19. Me shkresën nr. 1561/14 prot., datë 02.09.2025 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin si më poshtë:

Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1561/11 prot., datë 07.08.2025 me objekt “Kërkesë për informacion” kërkoj informacion nga Institucioni juaj.

Me shkresën nr. 4370/1 prot, datë 14.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/13 prot, datë 18.08.2024, është depozituar nga Institucioni juaj në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar, ku ndër të tjera informoni, si më poshtë vijon:

*[....] Operatori ekonomik “Silver” Shpk është titullar i kontratës me kod **AL0019382**, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: **Bunavi, Vlorë** [....].*

Nisur nga sa më sipër, në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

- 1. A ka patur detyrime të maturuara të energjisë elektrike për të paguar operatori ekonomik “Silver” SHPK më datë 19.05.2025, për kontratën me kod AL0019382, me adresë Bunavi, Vlorë?*
- 2. Nëse po, a janë paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të datës 19.05.2025 nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, për kontratën me kod AL0019382, me adresë Bunavi, Vlorë?*
- 3. Nëse detyrimet e maturuara të energjisë elektrike janë paguar nga ky operator ekonomik, ju lutem na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit të kryerjes së pagesës, për detyrimet e maturuara të datës 19.05.2025, të operatorit ekonomik “Silver” për kontratën me kod AL0019382, me adresë Bunavi, Vlorë?*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

II.20. Me shkresën nr. 4370/3 prot, datë 15.09.2025, me objekt “Kthim Përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1561/15 prot, datë 17.09.2025, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1561/14 Prot, datë 02.09.2025, protokolluar me tonën Nr. 4370/2 Prot, datë 04.09.2025, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion mbi kontratën e

energjisë elektrike me kod A0019382 në emër të operatorit ekonomik “Silver” shpk me Nipt K88010301S, ju informojmë si më poshtë:

1. *Të dhënat për kontratën e furnizimit me energji elektrike të operatorit ekonomik “Silver” shpk me Nipt K88010301S:*
 - *Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit rezulton se operatori ekonomik “Silver” shpk, është titullar i kontratës me kod AL0019382 me adresë në sistemin tonë të rregjistruar si Bunavi, Vlorë. Kjo kontratë ka qenë me përdorues kontrate “Elton Sina” për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025**.*
2. *Detyrimet e maturuara të operatorit ekonomik “Silver” shpk më datë 19.05.2025:*
 - *Për kontratën me kod AL0019382 të operatorit ekonomik “Silver” shpk, për të cilën sic u informuat më sipër me përdorues “Elton Sina” për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025**, më datë 19.05.2025 nuk figuron me detyrime ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal sha. Pagesa e faturës së muajt **Prill 2025** është kryer në datën **15.05.2025**, pra brënda afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e lëshimit.*
3. *Faturat e energjisë elektrike për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025** i përkasin përdoruesit të kontratës Elton Sina dhe jo titullarit “Silver” shpk. Kontrata me kod AL0019382 nuk ka asnjë detyrim të maturuar ndaj FSHU sha.*

II.21. Me shkresën nr. 2979 prot, datë 23.09.2025, me objekt “ Kërkesë për përshpejtim të shqyrtimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar mbi procedurat e prokurimit me objekt Shërbim Gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, protokolluar me tonën me nr. 1561/16 prot, datë 24.09.2025, është depozituar nga ana autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara kërkesë për përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Silver” SHPK me arsyetimin se: “Pika “e” e cila kërkon qe: e) ka paguar energjinë elektrike dhe ploteson kërkesat qe burojnë nga legjislacioni ne fuqi. Ky informacion kerkohet per Operatorete Ekonomike, te cilet operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise. - Sipas kesaj pike kerkojme qe te verifikohet nese ky operator ka dorzuar vertetimet perkatese te leshuara nga FSHU ne adresat ku ky subjekt tregtar ushtron aktivitetin e tij ekonomik. - Kontretisht duhet te kete te pakten 6 (Gjashte) numra kontratash ne listen e vertetimit te leshuar. Kontratat e energjise elektrike se bashku me adresat ne te cilat eshte titullar ose perdorues subjekti tregtar Silver SHPK, te cilat jan

aktive ditën e zhvillimit të tenderit. - A rezultojnë të jetë subjektet tregtarë Silver SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat e Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar Historik bashkalidhur ?. - nëse është përdorues në adresat e mësipërme (në ekstraktin e rregjistrimit tregtar historik), a ka patur detyrimin që subjekti tregtar Silver SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU ? Te figurojnë në emrin e kësaj shoqërie” Komisioni i Prokurimit Publik

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon: Ofertuesi deklaron se:

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

[...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “Silver” SHPK ka dorëzuar:

- Formulimin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur;

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT	
I. Unë i nënshkruari Z.Linard BALANI në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik SILVER shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:	
A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik	
Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	SILVER shpk
Numri NIPT/et:	
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	TIRANE
Përfaqësuesi (emri):	L. BALANI
Telefoni:	
E-mail:	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Ekstrakt,historik/tregtar,Certifikate rregjistrimi,Vertetim Status Aktiv
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetimi i gjendjes gjygesore per OE
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetimi i gjendjes gjygesore per OE
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetimi i Statusit Aktiv
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetimi i pageses se kontributeve.
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vërtetimi i debisë
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Nuk kemi shfaqur kurre anje mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Me shkresën nr. 1249/12 prot, datë 09.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/10 prot, datë 10.07.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik Silver shpk, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumenti:

Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-2593336UY, datë 14.04.2025, ku citohet: [...] Bazuar në

deklarimet e deklaruesit...z. L. B, vërtetohet se kërkuar Silver SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TRXXXXXXXXXX, përdorues i së ciles është Silver SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjise elektrike, vlerë e llogaritur deri me datën 14.04.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Mars 2025.

Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-8914126-AC, datë 20.05.2025, ku citohet: [...] Bazuar në deklarimet e deklaruesit...z. L. B, vërtetohet se kërkuar Silver SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) TRXXXXXXXXXX, përdorues i së ciles është Silver SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjise elektrike, vlerë e llogaritur deri më datën 20.05.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Prill 2025.

III.1.4 . Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.5. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi¹⁹;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe

përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e

tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.8 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Silver” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “Deklaratë Për për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, dhe nga dokumentacioni i dorëzuar në autoritet, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Silver” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomika ankimues “Dajti Park 2007” SHPK për skuafikimin e operatorit ekonomik “Silver” SHPK, në datën 03.07.2025 në formë shkresore, Komisioni i Prokurimit Publik, i dërgon shkresë Autoritetit Kontraktor Operatorit të Blerjeve Përqendruara në mbështetje të nenit 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga

operatori ekonomik “Silver” SHPK, i renditur i pari. Nëpërmjet shkresës nr. prot 1249/12, protokolluar në KPP me nr. 1561/10, datë 10.07.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, gjithsej 192 faqe. Referuar Pretendimeve të ankimesit, se operatori ekonomik “Silver” SHPK nuk përmbush kriterin lidhur me deklaratimet dhe vertetimet e OSHEE, Komisioni i Prokurimit Publik Me shkresën nr. 1561/11 prot., datë 07.08.2025 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin si më poshtë: “Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë: **1- Operatori ekonomik “SILVER” SHPK me numër NIPT-i: K88010301S, a ka lidhur me entin publik “OSHEE GROUP” SH.A. kontrata për furnizimin me energji elektrike, për adresat e mëposhtëme (Sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar): a. Tirane Tirane Tirane, Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Bajram Curri, Nr. Pasurie 5/247+1N4, Zona Kadastrale 8260, Pallati Palma e Arte, Kati 1-re, Tirane 1001. b. Vlore Orikum ORIKUM VLORE, REPARTI USHTARAK 2004, PASHALIMAN, VLORE. c. Tirane, Yzberisht, ZK 3866, Nr. Pasurie 306/179+2-N1. d. Vlore Orikum VLORE, Reparti Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Rradhimë, Vlorë. e. Shkoder SHKODER Shkoder, Reparti i Nderhyrjes së Shpejte, Rruga Levizja e Postribes. 2- Në cilën datë operatori ekonomik “Silver” SHPK me numër NIPTI K88010301S, ka paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të muajt mars 2025, për kontratën apo kontratat aktive me entin publik “OSHE Group” SHA ?; 3- A mund të konfirmohet, në mënyrë të plotë me përgjigje PO ose JO, nëse operatori ekonomik “SILVER” SHPK me numër NIPT-i: K88010301S, ka përmbushur detyrimin ligjor për të pasur kontratë të vlefshme furnizimi me energji elektrike për secilën nga vendet e ushtrimit të aktivitetit të sipërpërmendura në Pikën 1 ?”.** Me shkresën nr. 4370/1 prot, datë 14.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/13 prot, datë 18.08.2024, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin si më poshtë: “Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1561/11 Prot, datë 07.08.2025, protokolluar me tonën Nr. 4370 Prot, datë 11.08.2025, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion mbi kontratat e energjisë elektrike të cilat rezultojnë në emër apo në përdorim të operatorit ekonomik “S I L V E R” Shpk me Nipt K88010301S, ju informojmë si më poshtë: **1- Të dhëna për kontratat e furnizimit me energji elektrike të operatorit ekonomik “SILVER” Shpk, me NIPT: K88010301S: - Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit, rezulton se subjekti në fjalë është përdorues i kontratës së furnizimit me energji elektrike me kod TRXXXXXXXXX, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: Bajram Curri, nr. 247, 1. Kjo kontratë është me përdorues për periudhën 14 Tetor 2024 deri me 14 Tetor 2029; - Po ashtu, operatori ekonomik “SILVER” Shpk është titullar i kontratës me kod ALXXXXXXXXX, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: Bunavi, Vlorë. Kjo kontratë ka qënë në përdorim nga operatori ekonomik E. S, për periudhën 15 Korrik 2024 deri më 15 Korrik 2025; 2- Paga e faturës së muajit Mars 2025; - Për kontratën me kod TR1B030021141303, për të cilën siç u informuat më sipër është përdorues “SILVER” Shpk, paga e faturës së muajit Mars 2025 ishte kryer në datë 10.04.2025, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës. 3- Të dhëna të tjera për kontratat aktive: - Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit të FSHU SH.A. rezulton se subjekti nuk ka**

kontratë furnizimi (si titullar apo si përdorues) për çdo adresë të deklaruar sipas ekstraktit tregtar ashtu si kërkohet në shkresën tuaj. - Sikurse sqaruam më sipër, kontratë aktive në emër të tij është ajo për adresën "Bajram Curri, nr. 247, 1". Pas datës 15.07.2025 ka përfunduar afati i përdorimit për kontratën me kod ALXXXXXXX (operatori ekonomik Elton Sina, adresa "Bunavi, Vlorë"), e cila rezulton aktive për operatorin ekonomik "SILVER" sh.p.k. - Në sistemin tonë të faturimit, verifikimi se sa kontrata furnizimi ka një subjekt dhe statusi aktual i debisë kryhet nëpërmjet numrit të kontratës ose emrit të klientit, pasi adresat e regjistruara në sistem shpesh përkojnë me vendndodhjen e kabinave të furnizimit ose pikave të lidhjes dhe jo domosdoshmërisht me adresat reale të objekteve. Theksojmë se detyrimi i shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A. bazuar në ligjin Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe në Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike, është përmbushur, duke lidhur kontratat e furnizimit me energji elektrike me subjektin, si dhe duke menaxhuar në sistemin e saj të dhënat e kontratës, bazuar në kërkesat specifike të klientit. Dokumenti zyrtar që vërteton kontratat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë ndaj FSHU Sh.a. është "Vërtetimi i Debisë". Bashkëlidhur gjeni Vërtetimin e Debisë me nr. OSHEE-2025-2593336-UY, datë 14.04.2025, i cili përfshin informacionin për periudhën për të cilën ju referoheni.". Komisioni Prokurimit Publik pasi u njoh me përgjigjen e Furnizuesit të Shërbimit Universal, me shkresën nr. 1561/14 prot., datë 02.09.2025 me objekt "Kërkesë për informacion" ka kërkuar sërish informacion nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) si më poshtë: "Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1561/11 prot., datë 07.08.2025 me objekt "Kërkesë për informacion" kërkoi informacion nga Institucioni juaj. Me shkresën nr. 4370/1 prot, datë 14.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1561/13 prot, datë 18.08.2024, është depozituar nga Institucioni juaj në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar, ku ndër të tjera informoni, si më poshtë vijon: [...] Operatori ekonomik "Silver" Shpk është titullar i kontratës me kod ALXXXXXXX, me adresë në sistemin tonë të regjistruar si: **Bunavi, Vlorë** [...]. Nisur nga sa më sipër, në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë: 1- A ka patur detyrime të maturuara të energjisë elektrike për të paguar operatori ekonomik "Silver" SHPK më datë 19.05.2025, për kontratën me kod AL0019382, me adresë Bunavi, Vlorë ?; 2- Nëse po, a janë paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të datës 19.05.2025 nga operatori ekonomik "Silver" SHPK, për kontratën me kod ALXXXXXXX, me adresë Bunavi, Vlorë ?; 3- Nëse detyrimet e maturuara të energjisë elektrike janë paguar nga ky operator ekonomik, ju lutem na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit të kryerjes së pagesës, për detyrimet e maturuara të datës 19.05.2025, të operatorit ekonomik "Silver" për kontratën me kod ALXXXXXXX, me adresë Bunavi, Vlorë ?. Me shkresën nr. 4370/3 prot, datë 15.09.2025, me objekt "Kthim Përgjigje" protokolluar me tonën me nr. 1561/15 prot, datë 17.09.2025, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin si më poshtë: "Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1561/14 Prot, datë 02.09.2025, protokolluar me tonën Nr. 4370/2 Prot, datë 04.09.2025, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion mbi kontratën e energjisë elektrike me kod ALXXXXXXX në emër të operatorit ekonomik "Silver" shpk me Nipt K88010301S, ju informojmë si më poshtë: 1- Të dhënat për kontratën e

*furnizimit me energji elektrike të operatorit ekonomik “Silver” shpk me Nipt K88010301S: - Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit rezulton se operatori ekonomik “Silver” shpk, është titullar i kontratës me kod ALXXXXXXXX me adresë në sistemin tonë të rregjistruar si Bunavi, Vlorë. Kjo kontratë ka qenë me përdorues kontrate “E. S” për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025**. 2- Detyrimet e maturuara të operatorit ekonomik “Silver” shpk më datë 19.05.2025: - Për kontratën me kod ALXXXXXXXX të operatorit ekonomik “Silver” shpk, për të cilën sic u informuat më sipër me përdorues “E. S” për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025**, më datë 19.05.2025 nuk figuron me detyrime ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal sha. Paguesa e faturës së muajt **Prill 2025** është kryer në datën **15.05.2025**, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e lëshimit. 3- Faturat e energjisë elektrike për periudhën **Dhjetor 2024 – Qershor 2025** i përkasin përdoruesit të kontratës Elton Sina dhe jo titullarit “Silver” shpk. Kontrata me kod ALXXXXXXXX nuk ka asnjë detyrim të maturuar ndaj FSHU sha.*

III.1.9. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”

III.1.10 Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”

III.1.1 KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik pati korespondenca me Furnizuesin e Shërbimit Universal SHA si institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Furnizuesin e Shërbimit Universal Sh.A., informacionit të dhënë nga ky i fundit i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “Silver” SHPK nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Silver” SHPK

me dokumentacionin e dorëzuar në autoriteti kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, operatori ekonomik “Silver” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së, si dhe nga verifikimi i kryer pranë FSHU-së rezulton se operatori ekonomik “Silver” SHPK i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” Shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Silver” SHPK me arsyetimin se: *“Pika “h” e cila kërkon qe h) kryen aktivitetin ne perputhje me kërkesat e legjislacionit ne fuqi. - Kërkojme qe te verifikohet nese ky operator ka dorzuar Vertetimet perkatese te leshuara nga Tatimet konkretisht (për Kontributet e Sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a) ne te cilin duhet qe ne zbatim te kontratave te permendura me lart e cila me nje mbledhje te tjeshte te numrit total te stafit te kerkuar per kontratat qe ka ne zbatim eshte: 1. Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/Teknolog/ Pergjegjes Sherbimi) 6 Punonjes. 2. Kryekuzhinier 1 Punonjes. 3. Kuzhinier 11 Punonjes Punonjes. 4. Ndhimes Kuzhinier 16 Punonjes. 5. Punonjes shperndares ushqimesh 20 Punonjes. 6. Sanitare 2 Punonjes. 7. Shofer 7 Punonjes. Totali i punonjseve te kerkuar per te cilin ky subjekt tregtar ofron sherbimin eshte 59 Punonjes. Pa llogaritur speciliste te tjera si p.sh Administratori, Finacieri, Ekonomist, Jurist, Inxhinier Mjedisi apo speciliste te tjere te fushave ku kjo shoqeri ushtron aktivitetin e saj. - Te verifikohet sa eshte numri i punonjseve qe ka te deklaruar ne fushen e gatimit (kateringut) sipas kodeve perkatese qe e detyron ligii ne zbatim te VKM Nr. 514 datë 20.9.2017 për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar. - A ka ky subjekt numrin e kerkuar te stafit teknik duke qene se ushtron aktivitetin ne vende te ndryshme dhe ne zbatim te kontratave te nenshkruara duhet te kete numrin e kerkuar per sicilen kontrate pra të pakten 59 punonjes ? - Te verifikohet sa eshte numri i drejtueseve teknik qe ky subjekt ka te punesuar duke qene se ka aktive 5 Licenca per prodhim perpunim dhe shperndarje e ushqimeve per njerez. - Referuar Ekstraktit Historik te Shoqerise Silver sh.p.k rezulton se ka vetem dy Automjete Frigoriferike te regjistruara per ushtrimin e aktivitetit te kateringut dhe nderkohe ka te pakten 4 ambjente gatimi. Ne kontratat qe ka nenshkruar te cilat edhe gjografikisht jane shume larg njera tjetres (Orikum, Vlore, Tirane dhe Shkoder) si eshte mundur qe ky subjekt te ofroj sherbimin e tij ne furnizim dhe shperndarje te tre vakteve ushqimore ne 8 vende te ndryshme me dy automjete te regjistruara vetem ne Tirane ? - A jane keto mungese thelbsore per ushtrimin e aktiviteti ne zbatim te kushteve te sigurise Ushqimore ?”* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9, “Kriteret e Veccanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit, në

pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik janë përcaktuar kriteret si më poshtë:

2.3.8 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 9 (nëntë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Drejtues Teknik/Përgjegjës shërbimi <u>Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)</u>	1 (një)
2	Kryekuzhinier	1(një)
3	Kuzhinier	1 (një)
4	Ndihmës Kuzhinier	1 (një)
5	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2 (dy)
6	Sanitar/e	2 (dy)
7	Shofer	1 (një)
	Total	9 nëntë

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Drejtuesin Teknik/ Përgjegjës shërbimi, Kryekuzhinierin, Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh dhe Sanitar/e.

e) Për drejtuesin teknik/ Përgjegjës shërbimi (Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

f) Për kryekuzhinierin dhe Kuzhinierin:

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kryekuzhinier/ kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

g) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)

- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

h) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe sanitaret të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi dhe sanitar/e (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar pranë KPP-së, rezulton, se operatori ekonomik “Silver” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetdeklarimi i subjektit Silver Shpk;

																							
Deklarata	Përgjigje																						
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>																						
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: 60 Profili i punonjësve Mercologe , Krye Kuzhinierë, Kuzhinierë , N/d Kuzhiere, Punonjese shpendarje, Shofer, etj <table border="1"> <tr><td>1-</td><td>KIMISTE</td></tr> <tr><td>2-</td><td>Krye/KUZHINIERE</td></tr> <tr><td>3-</td><td>KUZHINIERE</td></tr> <tr><td>4-</td><td>Nd/ KUZHINIER</td></tr> <tr><td>5-</td><td>Nd/ KUZHINIER</td></tr> <tr><td>6-</td><td>Pun/Shperndarje</td></tr> <tr><td>7-</td><td>Pun/Shperndarje</td></tr> <tr><td>8-</td><td>Sanitare</td></tr> <tr><td>9-</td><td>Sanitare</td></tr> <tr><td>10-</td><td>Shofer</td></tr> <tr><td>11-</td><td>Shofer</td></tr> </table> <u>Makineri e mjete</u> Po [☒] Jo [☐] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1-Pajisje kuzhine per gatim 2-Frigorifere 3-Pajisje per servirje ushqimi,etj 4-Mjete frigoriferike ne pronesi te SILVER SHPK ,me targe / dhe targe 	1-	KIMISTE	2-	Krye/KUZHINIERE	3-	KUZHINIERE	4-	Nd/ KUZHINIER	5-	Nd/ KUZHINIER	6-	Pun/Shperndarje	7-	Pun/Shperndarje	8-	Sanitare	9-	Sanitare	10-	Shofer	11-	Shofer
1-	KIMISTE																						
2-	Krye/KUZHINIERE																						
3-	KUZHINIERE																						
4-	Nd/ KUZHINIER																						
5-	Nd/ KUZHINIER																						
6-	Pun/Shperndarje																						
7-	Pun/Shperndarje																						
8-	Sanitare																						
9-	Sanitare																						
10-	Shofer																						
11-	Shofer																						
Emri, Mbiemri																							
Firma																							
Vula																							

Nr	Profesioni	Numri i punonjesve	Dokumentacioni fizik i dorëzuar
1	Drejtues Teknik/Përgjegjës shërbimi <u>Mercollog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)</u>	1	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. V. B, datë 01.05.2023, Diplomë nr. 9350 të lëshuar nga UT, me titull Kimist Industrial, Librezë P, Listpagesa.
2	Kryekuzhinier	1	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. A. B, datë 01.04.2023, Certifikatë nr. 21463 të lëshuar nga DRFP Vlorë, Librezë P, Listpagesa.
3	Kuzhinier	1	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. SH. D, datë 16.05.2023, Certifikatë nr. 9350 të lëshuar nga UT, me titull Kimist Industrial, Librezë P, Listpagesa.
4	Ndihmës Kuzhinier	1	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. A. T, datë 16.05.2023, Librezë P, Listpagesa. Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. M. Z, datë 16.05.2023, Librezë P, Listpagesa.
5	Punonjës shpërndarës ushqimesh	2	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. P. H, datë 01.02.2025. Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. K. T, datë 01.02.2025.
6	Sanitar/e	2	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. GJ. L, datë 02.03.2025. Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. SH. B, datë 29.07.2024.
7	Shofer	1	Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. L. V, datë 04.02.2025, Leje Drejtimi. Kontratë pune midis subjektit Silver shpk dhe Znj. A. H, datë 06.02.2024, Leje Drejtimi.

III.2.3. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”

parashikohet se

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat për shërbime”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit

dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.2.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari 23 përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

III.2.8. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në

pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën

e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.11. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, ka hartuar kriterin e pikës 2.3.3. KPP konstaton, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar, të verifikohet, që operatorët ekonomikë të kenë staf të kualifikuar për kryerjen e shërbimi si dhe stafi i deklaruar të figurojë në listëpagesat e shoqërisë. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur në SPE dhe dorëzuar fizikisht pranë KPP-së, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Kontratat e Punës për secilin punonjës të deklaruar, Diplomën, Certifikatat e kualifikimit, Libreza Pune, Leje drejtimi, si dhe listëpagesa. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe atij fizik pranë KPP-së nga operatorit ekonomik “Silver” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit për të cilat ngre pretendime operatori ekonomik ankimues, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, konkretisht kriterëve të veçanta të kualifikimit të pikës 2.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe fizikisht nga ana e operatorit ekonomik “Silver” SHPK, Komisioni konstatoi që ky i fundit e plotëson kriterin 2.3.3, duke provuar se disponon punonjësit për realizimin e shërbimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues sa i përket pretendimeve të ngritura në lidhje me kontratat aktive që operatori ekonomik “Silver” SHPK ka, në lidhje me përmbushjen e kriterëve në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe pretendimit në lidhje me taksat vendore, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçantë të kualifikimit, nuk ka përcaktuar në asnjë moment që operatorët ekonomik ofertues duhet të deklarojnë që punonjësit dhe mjetet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi një kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar, si dhe për më tepër operatori ekonomik ankimues në dokumentacionin e ofertës ka dorëzuar Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe dokumentacion shoqërues sipas përcaktimeve ligjore. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi një kriter të pakërkuar dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK në procedurën e prokurimit “ *Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me numër reference Nr. REF-45063-04-15-2025, me objekt: “*Gatim dhe shpërndarje e ushqimit për Njësinë Speciale Renea, Njësinë Speciale Anti-Eksploziv dhe Njësinë Speciale Negocim*”, me fond limit 69,307,413 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh ose 696,486.91 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 19.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Dajti Park 2007*” ShPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

